

PROCESI I PLANIFIKIMIT OPERACIONAL

1. Cilat janë hapat e procesi të vendimmarrjes ushtarake (kapiten/major) cilat janë fazat e planizimit në nivel operacional (nënkolonel)?
2. Çfarë përfshin urdhri paralajmërues Nr.1 (kapiten/major), Cili është qëllimi i fazës 3a në procesin e planizimit në nivel operacional? (nënkolonel)
3. Cili është produkti kryesor i Analizës e Misionit (kapiten/major), cilat janë elementet e projektit operacional (nënkolonel)?
4. Çfarë janë detyrat e specifikuara, të nënkuptuara dhe thelbësore?
5. Çfarë janë faktet dhe supozimet që përdoren gjatë procesit të vendim marrjes ushtarake/planizimit në nivel operacional?
6. Çfarë duhet të kuptojë komandanti dhe shtabi kur analizon planin/urdrin e komandantit epror?
7. Çfarë janë Kërkesat e Komandantit për Informacion Kritik (KKIK)?
8. Çfarë është misioni i riformuluar?
9. Çfarë janë kriteret e vlerësimit të varianteve të veprimit?
10. Çfarë janë udhëzimet fillestare të Komandantit për planëzim dhe çfarë përfshijnë ato?
11. Cilat janë hapat që ndiqen gjatë hartimit të variantit të veprimit (kapiten-major). Çfarë është procesi i vlerësimit të rreziqeve dhe përse shërben ai? (Nënkolonel)
12. Cilat janë kriteret që duhet të plotësojë çdo variant veprimi?
13. Çfarë përmban skema e variantit të veprimit?
14. Për çfarë e ndihmon loja luftarake komandantin dhe shtabin?
15. Cilat janë metodat e lojës luftarake gjatë PVMU? Trajto njërën nga metodën e brezit (kapiten-major). Cilat janë metodat e lojës luftarake në procesin e planizimit në nivel operacional? Trajto njërën nga metodat (Nënkolonel).
16. Çfarë kriteresh duhet të plotësojë variani i zgjedhur, gjatë krahasimit të varianteve të veprimit?
17. Çfarë përfshin brifingu i vendimit?
18. Cilat janë paragrafët e Planit/urdhrit operacional (major-kapiten)/ çfarë është Qendra e Rëndesës dhe në cilat nivele operacioni gjendet ajo (nënkolonel)?
19. Çfarë përmban paragrafi i tretë i Planit/Urdhrit operacional(major-kapiten)/ Cilët janë elementët e analizës së qendrës së rëndesës, fol për dobësitë kritike (nënkolonel)?
20. Çfarë përmban paragrafi i parë i Planit/Urdhrit operacional? (Kapiten-major) Cilët janë elementet (sistemet) kyç që analizohen në kontekstin e një fushate? (nënkolonel)

Referenca:

- 1.) Procesi i Vendim Marrjes Ushtarake (Tiranë 2015), Materiali studimor pranë KDS-së.
- 2.) Direktiva e Planizimit Operacional (DPO)/COPD